

Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet

Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet

Raport Vjetor 2009



Mbrojtja nga rrezatimet e publikut personelit dhe mjedisit per tani dhe per brezat e ardhshem ne Shqiperi eshte nje proces ne vazhdimesi, i cili kerkon nje pune intensive te specialisteve te Zyres per Mbrojtjen nga Rrezatimet dhe te gjithë atyre institucioneve, te cilet jane te lidhur si me sigurine dhe sigurimin e materialeve radioaktive. Stafi i ZMR ka punuar si cdo vit ne zbatim te funksioneve qe jep ligji per mbrojtjen nga rrezatimet, ku misioni kryesor ka qene te perpunoje dokumentat legale per mbrojtjen e punonjesve dhe publikut nga efektet e rrezatimeve duke zhvilluar dhe krijuar sistemin e administrimit dhe kontrollit te mbrojtjes nga rrezatimet, i cili siguron mbrojtjen e publikut dhe mjedisit ne perputhje dhe me standartet nderkombetare si te ANEA dhe EU. Megjithë problemet e hasura puna ne ZMR gjate vitit 2009 ka pasur nje ngritje dhe problematika per mbrojtjen nga rrezatimet ka ardhur ne renie .

Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet ka patur dhe ka ne qender te vemendjes se tij sigurine dhe sigurimin e materialeve radioaktive ne Republiken e Shqiperise .Ne kete kuader ka gjetur mbeshtetje dhe udhezimi baze per detyrat kryesore dhe objektivat baze te vitit 2009.

Mbeshtetur ne dy shtyllat baze te sigurise dhe sigurimit dhe duke mare ne konsiderate raportin e Auditimit te Aneas' direktivat e EU ku percaktohen disa strukturime dhe shtimin e disa elementeve baze qe kane te bejne me sigurimin .Detyrat kresore te vitit 2009 ishin:

1. Mbledhje e dokumentacionit per subjektet private dhe shteterore, të cilat aplikojnë për marrjen e licenses
2. Realizim inspektimesh ne rang prefektore, te cilat nuk kane plotesuar te plote dokumentacionin per licensim
3. Inspektim subjektesh , të cilave u ka kaluar afati i licensës, duke mbajtur qendrim ligjor sic e përcakton rreullorja e sanksioneve
4. Pjesëmarrje ne projektet me BE dhe ANEA
5. Pershtatja e legjislacionit tone me ate te BE dhe plotesimi i matrices bashkengjitur
6. Firmosja e marreveshjes me Drejtorine e Pergjithshme te Doganave
7. Firmosja e marreveshjes me Drejtorine e Policisë së Shtetit
8. Bashkepunim me departamentin e promocionit te ISHP per fillimin e nje serie broshurash per promovimin e aktivitetit e zyres dhe shperndarjen e tyre ne rang republike
9. Perditesimi i inventarit kombetar i te gjithë burimeve te rrezatimit jonizues ne RSH
10. Instalimi i RAIS ne version SQL
11. Rritje e nivelit tone shkencor profesional nepermjet kualifikimeve te ndryshme, seminareve apo trajnimeve per te qene sa me eficente ne punen tone te perditshme dhe ne pjesemarrjen ne projektet qe kemi ne rang nderkombetar.
12. Ndryshimi i formatit te lejes per fillim aktiviteti .Pershtatja e termave ne ligj dhe dokumentat per licensim ne kuader te konceptit te ri te dhenies se licensave nga QKL.

U realizua dhe matrica ligjore e vitit 2009

Nr	Materiale per Kalim ne KM	Afati i pergatitjes
1	Amendime ne ligjin 8025 date 9/11/1995 i ndryshuar ne perputhje me ligjin e ri per lejet dhe licencat ne republiken e Shqiperise	Ne perputhje me aftine e ligjit te ri te licencave
2	Miratim i aplikimit per licencim per veprimtari qe perfshijne burime radioactive dhe gjeneratore me rreze x	Shtator 2009
3	Regullore mbi licencimin dhe inspektimin e Burimeve te rrezatimit jonizuese	Janar shkurt 2009
4	Regullore per menaxhim te sigurte te Mbetjeve radioactive	Janar shkurt 2009
5	Kategorizimi i burimeve	Maj 2009
6	Regullore mbi sigurimin fizk te materialeve radiaoktive	Shator 2009

Ne lidhje me rregulloren mbi sigurimin fizk te materialeve radiaoktive u la per tu perpunuar ne vitin 2010 me qellim qe te perfshihen Direktiva 2003/122

Në mbështetje të planit të punës për vitin 2009, ku janë të përcaktuara detyrat kryesore dhe objektivat bazë, Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet ka realizuar me përpikmëri detyrat e përcaktuara. Këto detyra lidhen me pranimin e dokumentacionit të aplikuesve për marrjen e licensës; vlerësimi i aplikimeve për licensë; inspektimi i kabineteve radiologjike në Republikën e Shqipërisë; lejet e import/eksportit dhe të transportit të burimeve të rrezatimit jonizues; etj.

APLIKIME PËR LICENSË DHE LICENSIMI

Gjatë vitit 2009 ka vijuar normalisht procesi i licensimit të përdoruesve të burimeve të rrezatimit jonizues mbështetur në rregulloren “Për licensimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimit jonizues”.Ky proces përfshin etapat që nga njoftimi pranë ZMR, dorëzimi idokumentaonit, vlerësimi i këtij dokumentacioni nga ana e inspektorëve të zyrës, miratimi në Komisionin e Mbrojtjes nga Rrezatimet dhe dhënia e licensës.

Lidhur me licensimin e Spitaleve Shtetërorë në Republikën e Shqipërisë deri në Qershor të vitit 2009 janë licensuar 4 Spitale Rajonalë dhe konkretisht Spitali Rajonal i rethit të, Lezhës, Dibrës, Fierit dhe Beratit.

Bazuar në Vendimin Nr. 2484/1, datë 16 Qershor 2009 të Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet këtë vit ka filluar dhe procesi i regjistrimit të grafive dentare të montuara në unitin dentar. Janë regjistruar 2 grafi të montuara në unitin dentar.

Janë miratuar nga KMR 34 licensa, nga të cilat 22 janë licensa të reja, 8 janë rinovim license, ndërsa 4 subjekte kanë amenduar licensën pasi kanë zgjeruar aktivitetin e tyre duke shtuar pajisje me burime të rrezatimit jonizues. Licensat e miratuara nga KMR për 2009 janë si më poshtë vijon:

- 1-Klinika Radiologjike “Studio Real”(Panoramex)
- 2- Klinika “Diplomat”(Grafi Skopi)
- 3-Spitali Rajonal Lezhë (Grafi dhe Skopi)
- 4-Spitali Rajonal Fier (Grafi dhe Skopi)
- 5-Spitali Rajonal Dibër (Grafi/skopi)
- 6-Spitali Jopublik “Universal German Hospital”(mamografi , grafi/skopi,CT-skaner, 2 grafi e lëvizshme,Koronarografi,Angiograf,grafi)
- 7-Kompania “Trebeshina” Sh.p.k(Burim radioaktiv Am-241)
- 8-Kabineti i radiologjisë SFI (grafi)
- 9-Spitali Rajonal Berat (Grafi/Skopi)
- 10-Laboratori Mjekësor”Neo –Style”,Tiranë (I-125,densitometer)
- 11-Klinika Radiologjike “FMES”,Tiranë (Coronarografi)
- 12-Kompania “Medfau”,Tiranë (import –eksport të gjeneratorëve me rreze X)
- 13-Klinika Radiologjike “Logli”,Gjirokastër (CT-Skaner)
- 14-Qendra Mjekësore “Tre Yjet),Tiranë (Grafi/skopi)
- 15-“Glob Diagnostic Center”,Tiranë (CT-Skaner,Mamografi,Grafi)
- 16-Studio Radiologjike “Gega-Quarta Colosso”,Vlorë(CT,Mamografi,Grafi,Panoramex)
- 17-“Univers-Alb”sh.a,Tiranëdhe Fier (CT-Skaner,Mamografi,Grafi/Skopi,Koronarografi, Litotript,Grafi,C-arm,densitometer)
- 18-Amendim i licensës për Klinikën “Ikeda”,Sukth (Grafi)
- 19-Amendimi licensës për Fondacionin “Zonja e Këshillit të Mirë”(1aparaturë panoramex dhe2 aparatura grafi dixhitale)
- 20-Shoqëria “Vëllezërit Elezi Arusha e ndërtimit”(grafi industriale me rreze X)
- 21-Shoqëria “Advantage Dental sh.p.k) (Panoramex)
- 22-Amendim i licenses “Nasto Inxhiniering” (grafi industriale I-192)
- 23-Klinika “Tirana Diagnostic Center”,Tiranë (CT-Skaner dhe Grafi)
- 24-Klinika Radiologjike “Egian”,Tiranë (Grafi,mamografi dhe panoramex)
- 25-Klinika Radiologjike Dentare,Durrës (Panoramex dhe Grafi Dentare)
- 26-Klinika Radiologjike Dentare,Lushnjë (Panoramex dhe Grafi Dentare)
- 27-Shoqëria “Saer-Medical”,Tiranë (import-eksport i aparaturave me rreze X)
- 28-“Posta Shqiptare”,Tiranë (Aparaturë inspektimi me rreze X për kontrollin e kolive postare)

- 29-Shoqëria “Agjensia Nacionale e Trafikut Ajror”,Tiranë (Aparaturë inspektimi me rreze X për kontrollin e objekteve të ndryshme)
- 30-Shoqëria “BNT-Elektonics”Tiranë (import-eksport te pajisjeve gjeneratorë me rreze X,instalim si dhe mirmbajtje të këtyre pajisjeve)
- 31-Shoqëria “Univers-Alb”,Tiranë,Amendim License (import-eksport dhe përdorim i burimeve të hapura I-131 dhe Tc-99m)
- 32-Shoqëria “A&A Security Survey”,Tiranë (import-eksport i aparaturave me rreze X)
- 33-Qendra Spitalore “Cardio&Diagnostic Center Hamburg/Tirana”,Tiranë (CT-Skaner,Grafi/skopi,Angiografi,mamografi)
- 34-Shoqëria “Coca-Cola Bottling”,Tiranë (Burim te mbyllur Am-241)



Nr i burimeve te rrezatimit jonizues te licensuar gjate vitit 2009										
G/S	Grafi	CT	Mamo	Coro/Angio	Panoram/ gr.dent	Densito meter	Gr.Ind	Burim i mbyllur	Burim i hapur	X-ray inspection
9	10	7	6	6	11	2	2	2	2	2

Në total janë licensuar 54 burime të rrezatimit jonizues, gjeneratorë me rreze X, 3 janë burime të mbyllura radioaktive dhe 2 qendra, të licensuara për importin dhe përdorimin e burime të hapura radioaktive, 4 subjekte janë licensuar për import-eksport të gjeneratorëve me rreze X.

Për të gjitha këto licensa është krijuar një dosje e vecantë, e cila mbahet pranë ZMR-së.

Në grafikun e mëposhtëm është bërë një shpërndarje e burimeve të rrezatimit jonizues sipas aparaturave me rreze X , burimeve radioaktive dhe lendëve të hapura të cilat përdoren nga subjekte të ndryshme në mjekësi dhe industri.

Duke krahasuar numrin e licensave të miratuara nga KMR në vitin 2008 me ato të miratuara gjatë këtij viti, vëmë re se kemi një rritje të tyre gjatë 2009.



INSPEKTIMI

Prioritet gjatë këtij viti për këtë zyrë ka qenë inspektimi dhe verifikimi i kabineteve shtetërore në prefekturat kryesore të Shqipërisë. Nga inspektimet e kryera në këto kabinete janë konstatuar parregullsi, që bien ndesh me legjislacionin në fuqi. Një nga elementët që ndeshet më shpesh në spitale dhe poliklinika shtetërore, është se aparaturat e reja nuk funksionojnë ose kanë probleme të ndryshme dhe kjo ndodh për vetë faktin se stafi nuk është i trajnuar për përdorimin e tyre, nuk ka angazhimin për një punë të sigurtë, dhe aspak kujdes në përdorimin e aparaturave dhe zbatimin e kushteve të sigurisë në punë. Shërbimi i mirëmbajtjes së tyre nuk funksionon me përjashtim në disa rast sporadikë në Tiranë.

Një problematikë tjetër është se shërbimi radiologjik në disa raste disponon aparaturë të vjetra jashtë çdo parametri teknik ku pacienti nuk është i mbrojtur nga

rrezatimi jonizues. Për këto qendra radiologjie duhet të merren masa urgjente për mbylljen e tyre ose për zëvendësimin me aparatura të reja.

Për të dalë nga kjo situatë, në mënyrë që të kemi një kosto të ulët dhe efikasitet të lartë në punë, ZMR ka theksuar në raportet të cilat u janë dërguar institucioneve përqëndrimin e shërbimit të radiologjisë në një qendër ku të përfshihen të gjitha shërbimet e imazherisë si grafi, skopi, CT-skaner duke siguruar kështu kontroll dhe cilësi më të lartë.

Një shqetësim tjetër që është hasur gjatë inspektimive është se, gjatë rikonstruktimit të kabineteve të radiologjisë që përdorin burime të rrezatimit jonizues nuk plotësohen kushtet e mbrojtjes. Duke parë këtë situatë duhet që këto subjekte të pajisen nga Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet me leje miratuese për fazën e parë me qëllim sigurimin e këtyre kushteve.

Inspektimet e kryera në rang republike përfshijnë qytetet: Tiranë, Berat, Fier, Lushnjë, Vlorë, Korçë, Pogradec, Ersekë, Peshkopi, Bulqizë, Burrel, Kukës, Shkodër, Lezhë dhe Durrës. Inspektimet në kabinetet e radiologjisë janë kryer në spital, poliklinike, sanatorium dhe dispanceri.


Disa prej kabineteve në qendrat spitalore, si: Spitali Rajonal i Beratit, Spitali Rajonal i Fierit, Lezhës dhe ai i Peshkopisë janë licensuar gjatë vitit 2009.

Gjithashtu inspektime janë kryer dhe në subjekte private, të cilat në krahasim me ato shtetërore plotësojnë kushtet në lidhje me sigurinë, sigurimin dhe mbrojtjen nga rrezatimet. Inspektimet janë kryer në subjektet e mëposhtme:

1. Spitali Jopublik “Universal German Hospital”(mamografi , grafi/skopi,CT-skaner, 2 grafi e lëvizshme, Koronarografi, Angiograf, grafi);
2. Qendra Mjekësore “Tre Yjet,Tiranë (Grafi/skopi);
3. Studio Radiologjike “Gega-Quartagolosso”, Vlorë(CT, Mamografi, Grafi, Panoramex)
4. “Univers-Alb”sh.a,Tiranë dhe Fier (CT-Skaner, Mamografi, Grafi/Skopi, Koronarografi, Litotript, Grafi,C-arm,densitometer);
5. “Nasto Inxhiniering” (grafi industriale I-192);
6. Klinika “Tirana Diagnostic Center”,Tiranë (CT-Skaner dhe Grafi);
7. Klinika Radiologjike “Egian”,Tiranë (Grafi,mamografi dhe panoramex);
8. Klinika Radiologjike Dentare,Lushnjë (Panoramex dhe Grafi Dentare);
9. Shoqëria “Univers-Alb”,Tiranë, (import-eksport dhe përdorim i burimeve të hapura I-131 dhe Tc-99m);
10. Qendra Spitalore “Cardio&Diagnostic Center Hamburg/Tirana”,Tiranë (CT-Skaner,Grafi/skopi,Angiografi,mamografi)
- 11.Klinika “Profiti”, Durres
- 12.Klinika “Enesi”, Durres
13. QSHNG, Patos, Fier
14. Shoqëria “Coca-Cola Bottling”,Tiranë (Burim te mbyllur Am-241)
15. Laboratori Mjekësor”Neo –Style”,Tiranë (I-125,densitometer)
16. Klinika Demiraqi, Tiranë
- 17.Soepro,Vlorë

Më poshtë po paraqesim me grafik inspektimet e kryera sipas qendrave radiologjike në rang prefekturë.

Inspektimet e kryera në rang prefekturë									
Prefekturat									
Tiranë	Berat	Dibër	Durrës	Fier	Korcë	Kukës	Lezhë	Shkodër	Vlorë
14	1	3	3	6	7	1	1	3	6



Nga shërbimet e planifikuara nuk u arrit të kryhej shërbimi në qarkun e Gjirokastrës (Gjirokastrër-Tepelenë-Përmet- Sarandë) , Elbasanit(Gramsh-Librazhd-Peqin), si dhe qyteti i Tropojes,Mirditës.

IMPORT-EKSPORTI

Procesi i import –eksporteve të materialeve radioaktive ka funksionuar mbështetur në VKM për import-eksportet në Republikën e Shqipërisë, Nr.158 datë 13/02/2008, udhëzuesin mbi import-eksportet e materialeve radioaktive Nr.4756/1,datë21/12/2006 dhe rregulloren për “Import-eksportin dhe tranzitin e burimeve radioaktive”, Nr3918/4, datë 3/11/2004.

Gjatë këtij viti janë dhënë 57 leje import-eksporti, dy prej të cilave nuk janë ekzekutuar për arsye teknike të subjekteve. Gjatë këtij viti janë kryer kryesisht importe dhe eksporte të burimeve radioaktive të mbyllura, të përfshira në grupin e sigurimit B,C ,burime të hapura radioaktive të cilat kryesisht përdoren për ekzaminime “in Vitro” dhe “in Vivo”, si dhe gjeneratorë me rreze X.

Më poshtë po paraqesim shpërndarjen e importeve dhe eksporteve të kryera gjatë 2009:

26 është numri i importeve për burimeve të hapura, I-131, Tc-99m nga Kompania “Medicare”

9 është numri i importeve për burime të hapura radioaktive I-125 nga Laboratori “Neo-Style”.

2 importe janë kryer nga Klinika Domi, Kite Ria

5 (por janë ekzekutuar 4) është numri i importeve për burim Ir-192 HDR nga QSUT, Departamenti i Onkologjisë, të cilat përdoren për trajtimin e pacientëve me kancer.

2 është numri i importeve për burim të mbyllur Ir-192, grafi industriale, të cilat përdoren në industri për metodat NDT nga Kompania “Nasto Inxhiniering”.



QFBZ ka importuar 1 aparaturë Troxler me burim Am-241Be dhe Cs-137, e cila përdoret për matjen e lageshtisë.

Kompania Trebeshina ka importuar 1 burim Am-241, i cili do të përdoret nga kjo kompani për matjen e nivelit në shishet e ujit.

5 janë importe të kryera për gjeneratorë me rreze X.

6 (5 janë ekzekutuar, QSUT-nuk e ka kryer eksportin për arsye teknike) prej tyre janë eksporte të burimeve të mbyllura që sipas kontratave të realizuara nga subjektet janë kthyer tek prodhuesi në fund të jetës/ose përdorimit të tyre.

Import-Eksporte 2009				
Subjekti	Nr. importeve	Nr. eksporteve	Burim i hapur/i mbyllur	Gjeneratorë me rreze X
Medicare	26	-----	I-131, Tc-99m	-----
Neo-Style	9	-----	I-125	-----
Klinika Domi	2	-----	Kite Ria	-----
QSUT	4	3	Ir-192	-----
Nasto Inxhiniering	2	1	Ir-192 grafi industriale	-----
QFBZ	1	1	Am-241Be, Cs-137 , Ir-192 grafi industriale	-----
Trebeshina	1	-----	Am-241	-----
A&A Security	2	-----	-----	Pajisje X-ray inspection
Hygeia Hospital	1	-----	-----	Akselerator Linear
Vellezerit Elezi	1	-----	-----	Grafi industriale me rreze X
Rakrom Tirana	1	-----	-----	Spektrometer



Duke bërë një krahasim me import-eksportet e kryera gjatë vitit 2009 me ato të kryera në vitin 2008, vëmë re se kemi një rritje të importeve dhe eksporteve gjatë 2009.

TRANSPORTI

Në lidhje me lejet e transportit gjatë kësaj periudhe janë dhënë 49 leje transporti për transportin e burimeve të hapura dhe të mbyllura, nga të cilat 25 janë leje të lëshuara për transportin e burime të hapura radioaktive I-131, Tc-99m, 10 janë leje transporti për burime të hapura I-125 dhe 14 janë leje transporti për burime të mbyllura, të cilat gjejnë përdorim në fushën e mjekësisë dhe industrisë. Transporti në Republikën e Shqipërisë kryhet nga subjekte të licensuara nga KMR dhe që zbatojnë të gjitha dispozitat e rregullores për “Transportin e sigurtë të materialeve radioaktive” Nr.3918/1 datë 03/11/2004, si dhe të gjitha dispozitat e tjera që lidhen me transportin. Këto kompani të licensuara janë Qendra e Fizikës Bërthamore të Zbatuar dhe Qendra Medicare.

Gjatë 2009 janë dhënë 25 leje transporti për kompaninë Medicare, burime të hapura, I-131 dhe Tc-99m,


10 leje transporti për burime të hapura, I-125.

14 leje transporti për burime të mbyllura, të kryera nga QFBZ, për subjektet QSUT, Nasto Inxhiniering, Trebeshina


Në grafikun e mëposhtëm po paraqesim një shpërndarje të lejeve të dhëna për vitin 2009.

Transportet e kryera gjatë 2009		
Kompania	Nr. i transporteve të kryera	Lloji i burimit të mbyllur/ose të hapur

Medicare	35	I-131, Tc-99m, I-125
QFBZ	14	Ir-192, Am-241, Cs-137



Duke krahasuar transportet e kryera në vitin 2008 me ato që janë kryer gjatë 2009, vëmë re një rritje të transporteve të kryera për burime të mbyllura radioaktive dhe të hapura, të cilat po i paraqesim më poshtë me grafik.



PROJEKTET ME BE DHE IAEA-në

Një nga drejtimet kryesore në planin e vitit 2009 ka qënë dhe pjesëmarrja në projektet e BE-së dhe IAEA-së. Gjatë këtij këtij janë realizuar disa takime me ekspertë të BE ku dhe janë bërë vlerësime në lidhje me projektet e mëposhtëme:

- 1-Vlerësimi i rregulloreve dhe menaxhimi i praktikave të mbetjeve spitalore.
- 2-Vlerësimi i rregulloreve dhe menaxhimi i Norm dhe Tenorm.
- 3-Vlerësimi i Trupës Rregullatore .
- 4-Monitorimi i mjedisit lidhur me radioaktivitetin në ajër, ujë dhe tokë.
- 5-Siguria dhe sigurimi i burimeve radioaktive ne shqiperi

Në lidhje me projektin e parë, mbi vlerësimin e rregulloreve dhe menaxhimin e praktikave të mbetjeve spitalore ku janë të përfshirë ZMR, Mjekësia Bërthamore në QSUT si dhe QFBZ, në datat 19-20 Shkurt 2009 grupi i ekspertëve të EU bëri një vlerësim për sa i takon situatës në Shqipëri duke pasur si objekt vlerësimin e rregulloreve që lidhen me menaxhimin e mbetjeve spitalore, përfshirë këtu inventarin e radionuklideve si dhe rekomandime mbi legjislacionin, menaxhimin dhe zhvillimin e aplikimeve mjekësore.

Në datat 14-15 Mars 2009 grupi i ekspertëve të EU bëri vlerësimin e rregulloreve mbi menaxhimin e Norm dhe Tenorm, përshtatshmërinë e tyre me rekomandimet e EU-së dhe ANEA-s. Objekt i këtij vlerësimi ishte dhe zhvillimi i metodave për marrjen e informacionit ose të dhënave rreth site-ve dhe aktiviteteve industriale që gjenerojnë Norm dhe Tenorm. Në këtë projekt janë të përfshirë Gjeoshkenca dhe ZMR. Gjatë muajit Qershor janë kryer inspektime në dy qendra, Albpetrol Fier dhe Superfosfatin e Laçit. Në këto qendra janë bërë vlerësime në lidhje me përqëndrimin e radionuklideve dhe përcaktimin e dozave në publik.

Mbi vlerësimin e Trupës Rregullatore në datat 6-8 Prill 2009 grupi i ekspertëve bëri një vlerësim të kësaj trupe në lidhje me statusin e kësaj organizate, kapacitetet, stafin si dhe mekanizmat financiarë të saj.

Në datat 27-28 Prill 2009 është zhvilluar një takim me eksperte të EU-së në lidhje me vlerësimin e rregulloreve, të cilat përfshijnë kontrollin e radioaktivitetit në ajër, ujë dhe tokë. Qëllimi i këtij projekti ishte vlerësimi i statusit të legjislacionit dhe infrastrukturës rregullatore, e cila duhet të jetë në përshtatje me kërkesat e artikullit 35 të Euratom. Për sa i takon projekteve TSA1, TSA2 në bashkëpunim me IAEA-në, janë në vazhdim dhe përfshijnë forcimin e trupës rregullatore për kontrollin e materialeve radioaktive dhe kontrollin e ekspozimeve profesionale nga rrezatimet jonizuese si dhe optimizimin.

PKZMSA

Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet po punon dhe për përshtatjen e legjislacionit shqiptar që përfshin mbrojtjen nga rrezatimi me legjislacionin evropian në kuadër të integritetit të Shqipërisë në Europë. Detyrimet që duhet të përmbushë Shqipëria reflektohen në Planin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKMZSA), që është instrumenti bazë i procesit të Integritetit Evropian. Ky dokument strategjik përfshin inisiativat ligjore dhe aktivitetet zbatuese të prioritetëve të adresuara nga Dokumenti i Partneritetit Evropian (2007) dhe Raporti Vjetor i KE (2008).

Edhe këtë vit ZMR ka punuar dhe raportuar për progresin e raportit në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet. Raportimi i fundit ka mbuluar periudhën tetor 2008–maj 2009. Konkretisht, janë ripunuar Rregulloret mbi “Liçensimin dhe inspektimin e burimeve të rrezatimit jonizues” dhe “Menaxhimin e sigurtë të mbetjeve radioaktive” janë përafuar nga ZMR me Direktivat e BE dhe “Kategorizimi i burimeve radioaktive”, me relacionet përkatëse, të cilat janë miratuar me VKM.

Një realizim tjetër i këtij viti janë dhe konventat “Për sigurinë bërthamore” dhe “Për sigurinë dhe menaxhimin e lëndës djegëse të konsumuar dhe për sigurinë e menaxhimit të mbetjeve radioaktive”, që do të kalojnë për ratifikim në Këshill të

Ministrave. Ratifikimi i këtyre konventave është detyrim i vendit, sic është pasqyruar ne progres raportin 2008 dhe e përcaktuar dhe në raportin vjetor të KE 2008.

Në lidhje me këtë pikë i është dërguar një shkresë Sektorit Juridik pranë Ministrisë së Shëndetësisë, për dërgimin e tyre në mënyrë zyrtare në Ministrinë e Drejtësisë, në mënyrë që të bëhet certifikimi i përkthimit nga ky institucion e më pas të kalohen për miratim në parlament.

PYETËSORI BE

ZMR ka punuar për plotësimin e pyetësorit të BE-së. Konkretisht, ZMR është përfshirë drejtpërdrejt në plotësimin e përgjigjeve të kapitullit 15, Energjia (Mbrojtja nga Rrezatimet). Njëkohësisht ka patur përgjigje dhe për kapituj të tjerë të pyetësorit, sic janë Kapitulli 3, 28.

BDTI

Shqipëria është bërë pjesë në sistemin e Bankës së të Dhënave për Trafikun Illegal (BDTI) të lëndëve radioaktive pranë Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (IAEA). ZMR ka filluar punën dhe po punon aktualisht me mbledhjen e të dhënave dhe sistemin e këtij lloj informacioni në bashkëpunim me Institucione të tjera shtetërore shqiptare dhe me Agjencinë. Ky informacion përshtatet në një format në përputhje me dokumentat e ANEA-s, ku përshkruhet natyra e incidentit si dhe ndarja në kategori e saj. Në bazë të kësaj tablele do të kategorizohen natyrat e incidenteve me materialet radioaktive në vendin tonë.

MBLEDHJET E KMR-së

Gjatë vitit 2009 janë realizuar 6 mbledhje të KMR ku dhe janë marre disa vendime. Tashme komisioni nga muaji korrik vepron dhe funksionon në bazë të VKM-së “Për ngritjen, përbërjen, funksionimin dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Komisionit të mbrojtjes nga Rrezatimet”, Nr.510 datë 13.05.2009.

KMR gjatë këtij viti ka miratuar ndryshimet në aplikimet për liçense ku është shtuar termi në lidhje me të dhënat për pajisjet mbrojtëse për fëmijët si dhe trashësinë e përparëseve të plumbit.

KMR ka miratuar gjithashtu:

- Njoftimin për regjistrim për grafitë dentare të montuara në unitin dentar, të cilat do të përdoren për raste emergjente.
- Rregullore e funksionimit të Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet.
- Gjithashtu KMR miratoi gjatë këtij viti programet e trajnimit për ekspertë të kualifikuar dhe atributin për zbatim ia kaloi QFBZ.

-Gjithashtu me propozim të Kryetarit të KMR-së u ngrit një grup pune për rishikimin e draftit për rrezatimet jojonizuese. Duke parë se KMR ka kapacitete për mbulimin dhe të rrezatimeve jojonizuese, në këtë kuadër kjo pjesë do të mbulohet nga ky komision, i cili do të jetë si Trupë Rregullatore dhe Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet si ekzekutiv i saj. Grupi i punës ka zhvilluar takime në lidhje me këtë çështje dhe është punuar mbi draftin i cili duhet të paraqitet në KMR brenda muajit janar.

Sipas matricës ligjore për vitin 2009 është punuar në lidhje me rregulloret, “Për punë të sigurtë me burime të rrezatimit jonizues”, “Për liçensimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimit jonizues” dhe “Trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve radioaktive”, të cilat tashmë kanë kaluar për miratim në parlament. Për sa i takon rregulloret është bërë dhe përafrimi me Direktivat e EU dhe janë përgatitur për të treja rregulloret tabelat përkatëse të përputhshmërisë me këto Direktiva. Gjithashtu një çështje e rëndësishme ka qënë dhe diskutimi në KMR mbi survejancën mjekësore dhe me propozim të Kryetarit të KMR-së për punonjësit e angazhuar me burime të rrezatimit jonizues të bëhet një ekzaminim më i plotë, pasi nuk është e mjaftueshme vetëm analiza e gjakut për të diagnostikuar problemet shëndetësore të punonjësit. Për këtë çështje do të bëhet një klasifikim i punonjesve. Ata të cilët punojnë me burime të rrezatimit jonizues të kategorisë I dhe II, si dhe radiologjia intervencionuese do të rekomandohet përveç analizës së gjakut dhe një ekzaminim me rezonance magnetike.

Në mbledhjen e fundit të KMR është diskutuar dhe puna për promovimin lidhur me mbrojtjen nga rrezatimi jonizues. Për këtë do të bashkëpunohet me Departamentin e Promocionit në ISHP dhe është përcaktuar një plan pune. Ky plan përfshin përgatitjen e një fletëpalosjeje dhe një posteri që do të shpërndahen në të gjithë Shqipërinë pranë Kabineteve që ushtrojnë veprimtari me burime të rrezatimit jonizues.

Në mbështetje të ligjit Nr.8025, datë 9/11/2009, “Për mbrojtjen nga Rrezatimet, i nryshuar si dhe në mbështetje të VKM mbi import-eksportet e materialeve radioaktive në Republikën e hqipërisë, ka dalë një urdhër i MSH për bashkëpunimin me vendet fqinje në lidhje me sigurimin dhe sigurinë për një punë të sigurtë me burime të rrezatimit jonizues. Zyra do të fillojë negociatat me re trupat rregullatore të vendeve fqinje Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi, Greqi dhe Itali me qëllimin e nënshkrimit të marrëveshjes së mirkuptimit me këto vende për import-eksportin dhe transportin e materialeve radioaktive si dhe shkëmbimin e eksperiencave me qëllim krijimin e urave lidhëse në këto fusha.

MATRICA LIGJORE

Një çështje tjetër, e cila ka pasur prioritet për ZMR, lidhet me realizimet për matricën ligjore 2009. Për realizimin e saj është kërkuar dhe mbështetja e Sektorit Juridik, pranë Ministrisë së Shëndetësisë. Rregulloret mbi “Liçensimin dhe inspektimin e burimeve të rrezatimit jonizues” dhe “Menaxhimi i sigurtë të mbetjeve radioaktive” janë përafruar nga ZMR me Direktivat e BE dhe “Kategorizimi i burimeve radioaktive, të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave (në pritje të zbardhjes në Fletoren Zyrtare).

Në lidhje me matricën ligjore për vitin 2010 do të rishikohen rregulloret e mëposhtme:

1-Rregullore për “Sigurimin fizik të materialeve radioaktive”

2-Rregullore për “Transportin e sigurtë të materialeve radioaktive”

3-Rregullore për “Punë të sigurtë me burimet e rrezatimeve jonizuese”

Afati për rishikimin dhe përafrimin e tyre me Direktivat Europiane është brenda katërmujorit të parë të vitit 2010.

TRAJNIME dhe WORKSHOP-e

Gjatë vitit 2009 janë kryer disa takime dhe trajnime, të cilat kanë ndikuar në ngritjen e nivelit shkencor të stafit të Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimet.

Në nëntor të këtij viti në bashkëpunim me IAEA-në dhe Ambasadën Amerikane dhe KMR-në u zhvillua trajnimi në lidhje me temë “Lufta kundër trafikimit ilegal të materialeve radioaktive dhe bërthamore”, ku morën pjesë përfaqësues nga institucione të ndryshme, Doganat, Ministria e Brendshme, SHISH etj

Në kuadrin e forcimit të institucioneve Kosovare në datat 12-14 Janar u zhvillua një takim me përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Kosovës ku u diskutua në lidhje me legjislacionit për mbrojtjen nga rrezatimet dhe sigurinë nukleare. Gjithashtu inspektorët e zyrës kanë marrë pjesë në trajnime të ndryshme në vende si Rumani, Gjermani, Bruksel, Austri, Lituani etj